

**zSUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-136/13

**Prishtinë/Priština,
27 maj 2014**

Në çështjen juridike të:

**R.Q.S
A.R.S
R.Q.S**

Të përfaqësuar me autorizim nga B.J
Avokat

Në tekstin e mëtejme të referuar si:

Palët ankuese

kundër.

Nuk ka:

Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit, Dag Brathole dhe Emine Kaqiku, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/172/2012, të datës 24 tetor 2012 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 92423 dhe në tekstin e mëtejme i referuar si: vendimi i KKPK-së), pas shqyrtimit të mbajtur më 27 maj 2014, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa;
2. Vërtetohet vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/A/172/2012, i datës 24 tetor 2012, sa i përket lëndës së regjistruar me numrin KPA 00902.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Gjykata Supremet i merr si fakte të vërtetuara nga KKPK-ja dhe që nuk kontestohen nga palët apo të dëshmuara si të gabueshme çështjet në vijim

1. Më 14 dhjetor 2006, R.S ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së tij pronësore mbi një ngastër të tokës në Vitomiricë të Pejës – “Te Mulliri Rajkur”, ngastra kadastrale numër 679/1, më sipërfaqe prej 01.16.47 ha (në tekstin e referohet si: prona).
2. Njoftimi i kërkesës pronësore është bërë me rregull më 30 maj 2008, duke vendosur një shenjë në pronë.
3. KKPK-ja kishte vendosur se kërkesa duhej të hidhej poshtë si i papranueshme pasi që humbja e pronës nuk ndërlidhje me konfliktin e armatosur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
4. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar R.S më 15 maj 2013.
5. Palët ankuese kanë paraqitur ankesë në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 4 qershor 2013, që është brenda afatit prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 12. 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme, përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50).
6. Q.S.V ishte pronar i ligjshëm i pronës, ai e kishte humbur posedimin e pronës në vitin 1946 pasi që ajo ishte konfiskuar nga Qeveria Federative Jugosllave.
7. Sipas certifikatës nr. 01-3/86 të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi i Kuvendit Komunal të Pejës, të datës 11 shtator 2000, prona ishte regjistruar në emër të B.B.D nga Vitomirica. Sipas fletës poseduese nr. 490 të datës 26 gusht 2008, prona ishte regjistruar në emër të K.S.Ç.
8. Palët ankuese po ashtu kanë paraqitur padi civile në Gjykatën Komunale në Istog më 31 korrik 2007. Gjykata e ka shpallur vetën jokopetente me aktvendimin e datës 3 korrik 2008 (nr.151/07).

9. Me gjasë një padi tjetër civile është paraqitur në Gjykatën Themelore në Pejë sipas kërkesës së datës 13 prill 2013 për lëshimin e masës së përkohshme dhe për caktimin e shqyrtimit gjyqësor në lëndën nr. 517/08.

Pretendimet e palëve

10. Palët ankuese, pasardhësit dhe trashëgimtarët e pretenduar të Q.S.V kërkojnë konfirmimin e së drejtës së tyre pronësore mbi pronën pasi që posedimin dhe shfrytëzimin e pronës e kanë marrë palët e treta. Për të kundërshtuar vendimin e KKPK-së, palët ankuese kanë deklaruar se vendimi i KKPK-së është marrë:
- me shkeljen esenciale të dispozitave procedurale;
 - me zbatimin e gabuar të dispozitave të së drejtës materiale;
 - me vërtetimin jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike duke injoruar provat relevante ligjore dhe duke mos vlerësuar provat materiale lidhur me lëndën, në dobi të paraqitësit të kërkesës/palës ankuese.
11. Prandaj, palët ankuese kërkojnë që:
- të refuzohet si e pabazuar ankesa;
 - të priset vendimi i KKPK-së dhe lënda të kthehet për rishqyrtim në AKP;
 - palët përgjegjëse në kërkesë ta lirojnë dhe ta dorëzojnë pronën;
 - palët përgjegjëse në kërkesë t'ia paguajnë shumën prej 650 € palëve ankuese në emër të kompensimit të shpenzimeve procedurale
 - të urdhëroj nxjerrjen e masë së përkohshme me qëllim që palët përgjegjëse në kërkesë t'i parandalojë nga ndryshimi i gjendjes administrative dhe faktike.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

12. Ankesa është pranueshme.

Juridiksioni

13. Gjykata Supreme ka juridiksion.

Meritat

14. Pasi që KKPK-ja e ka hedhur poshtë kërkesën e palës ankuese për arsye se nuk është në juridiksion të KKPK-së, pyetjes që duhet dhënë përgjigje nga Gjykata Supreme është nëse KKPK-ja ka ose jo juridiksion.

15. Juridiksioni i KKPK-së përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, i cili thekson se KKPK-ja ka kompetencë që t'i zgjidhur *“kategoritë vijuese të kërkesave që janë të lidhura me konfliktin, duke përfshirë rrethanat që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me to ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ndodhi në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999:*
kërkesat e pronësisë lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe kërkesat lidhur me të drejtat mbi shfrytëzimin e pronës së paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,
ku paditësi aktualisht nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtat e tilla pronësore
16. Nuk është kontestuese, e as që ka ndonjë dyshim se prona ishte konfiskuar nga ish-Qeveria Federative e Jugosllavisë në vitin 1946. Që nga ajo kohë, ish-pronari e pas tij edhe trashëgimtarët e tij nuk kanë qenë në gjendje që të ushtrojnë të drejtat e tyre pronësore. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se kërkesa e “ndërlidhjes me konfliktin” nuk është plotësuar në rastin aktual.
17. Këto rrethana si rrjedhojë kanë bërë që KKPK-ja të mos ketë pasur juridiksion për këtë çështje.
18. Sa i përket pretendimeve të palëve ankuuese në ankesën e tyre se ka pasur shkelje të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60 të datës 31 tetor 2000, më saktësisht të neneve 2 dhe 3 lidhur me humbjen e pronës si rezultat i diskriminimit, Gjykata Supreme nuk e mbështet ankesën as në këtë aspekt.
19. Pasi që prona nuk është humbur në periudhën ndërmjet 23 marsit 1989 dhe 24 marsit 1999, kjo rregullore nuk është e zbatueshme.

Konkludim

20. Kjo bën që Gjykata Supreme të arrijë në përfundim se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë mbi bazën e arsyeve të drejta.

Këshille ligjore

21. Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Willem Brouwer, Kryetar i Kolegjit EULEX

Emine Kaqiku, Gjyqtare

Dag Brathole, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it